



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2021

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 13.12.2021)

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 11:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-----------------------------|--------------------------|
| <i>1. Naureda Llagami</i> | <i>(kryetare)</i> |
| <i>2. Maksim Qoku</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>3. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>4. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>6. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>10. Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>11. Erjon Muharremaj</i> | <i>(anëtar)</i> |

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Staf i administrativ i KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit për deklarimin e mbarimit të mandatit të 3 (tre) anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Medi Bici, z. Ilir Toska, znj. Brunilda Kadi.

Naureda Llagami: Përshëndetje të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 13.12.2021.

Siç jeni në dijeni, në rendin e ditës Këshilli do marrë në shqyrtim projektvendimet që lidhen me deklarimin e mbarimit të mandatit të tre anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Medi Bici, z. Ilir Toska dhe znj. Brunilda Kadi.

Në fakt më lejoni të përshëndes kolegët e rinj dhe t'i mirëpresim, z. Ridvan Hado, znj. Irena Plaku dhe z. Klodian Kurushi, të cilët i bashkohen sot misionit tonë të përbashkët, për konsolidimin e Këshillit, por edhe për përballimin e sfidave me të cilat përballet sot sistemi i drejtësisë.

Kjo në fakt është përtëritja e parë e këtij Këshilli që prej konstituimit të tij, dhe në fakt të jesh pjesë e KLGJ-së është një shërbim, një mision, një përgjegjësi, ashtu siç është edhe një privilegj, kontribut dhe promovim. Prandaj kjo përtëritje është e nevojshme për të mbajtur këtë Këshill të gjallë dhe koherent ndaj nevojave dhe pritshmërive të të gjithë komuniteteve që përfaqësojnë sistemin e drejtësisë. Për të siguruar llogaridhënien e nevojshme, përgjegjshmërinë dhe përgjegjësinë në shërbimin tonë ndaj publikut, ndaj qytetarit, sot mund të themi se e kemi kaluar me maturi këtë sfidë. Prandaj, së pari, dua t'ju uroj punë të mbarë kolegëve të rinj. Keni ardhur në momentin e duhur, për t'u bërë pjesë e vendimmarrjeve të rëndësishme që na presin.

Kolegët para jush e kanë përgatitur rrugën, kolegët të cilët e përfunduan mandatin e tyre dhe do t'i bashkohen gjykatave dhe komunitetit të juristëve, për kontributin e tyre gjatë këtyre tre viteve të parë të Këshillit, në hartimin e rregulloreve, vendosjen e standardeve dhe çuarjen më tej të proceseve të rëndësishme, si dhe ngritjen e Gjykatave të Posaçme apo Gjykatës së Lartë, dhe deri tek hartimi i një projekti dinjitoz për riorganizimin e sistemit gjyqësor. Jam e bindur që së bashku do ia dalim.

Atëherë, kalojmë në shqyrtimin e tre projekt-akteve, të cilat kanë të bëjnë me deklarimin e mbarimit të mandatit, kështu, projekt-akti i parë, në zbatim të nenit 147/b të

Kushtetutës, nënseksioni I, ku parashikohet që: “1. Mandati i anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor mbaron sipas rasteve të mëposhtme: a) mbush moshën e pensionit; b) përfundon mandatin 5–vjeçar; c) jep dorëheqjen; ç) shkarkohet sipas parashikimeve të nenit 147/c të Kushtetutës; d) vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit; dh) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën. 2. Mbarimi i mandatit të anëtarit deklarohet me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor.”.

Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve, siç jeni në dijeni, e mbledhur më datë 08.10.2021, bazuar në nenin 13, pika 1 dhe 4, si dhe në nenin 147, pika 1/d të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, ka zgjedhur tre anëtarët:

Përfaqësues nga Gjykata e Lartë, z. Klodian Kurushi;

Përfaqësues nga gjykatat e apelit, z. Ridvan Hado;

Përfaqësues nga gjykatat e rretheve gjyqësore, znj. Irena Plaku.

Vijojmë me projekt–aktin e parë që ka të bëjë me deklarin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Medi Bici. Jemi dakord?

Maksim Qoku: Dakord.

Irena Plaku: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Medi Bici.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt–aktin e dytë që ka të bëjë me deklarimin e mbarimit të mandatit anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Ilir Toska. Jemi dakord?

Maksim Qoku: Dakord.

Irena Plaku: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Ilir Toska.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt–aktin e radhës që ka të bëjë me deklarimin e mbarimit të mandatit anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Brunilda Kadi. Jemi dakord?

Maksim Qoku: Dakord.

Irena Plaku: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Brunilda Kadi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me kaq po e mbyllim mbledhjen për sot.

Faleminderit!

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor